



**AWR ABBRUCH GMBH**  
www.awr-abbruch.de

# ASOCIACIONI, 'KUSHT MBI KUSHTET'

FAQE 4-5



Armand Nismani (AFP)

Themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë është "kusht mbi të gjitha kushtet" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve. Pa

përparim në këtë pikë "nuk mund të ketë përparim as në çështjet e tjera" për të cilat diskutohet në këtë dialog. Kështu thonë disa burime diplomatike në Bruksel, duke pranuar, ndonëse jozyrtarisht, se

Asociacioni është prioriteti numër një, edhe pse Marrëveshja e Ohrit midis Kosovës dhe Serbisë, që duhet të shpjerë në normalizimin e marrëdhënieve mes tyre, duhet zbatuar plotësisht

## AKTUALE



**PA SUKSES NË FUSHËBETEJË, NDIHMAT PËR UKRAINËN MUND TË VIHEN NË RREZIK** F.2

**KËSHILLI I AMBASADORËVE SHQIPTARË I SHKRUAN KIE-SË: SITUATA E SHQIPTARËVE NË LUGINË TË PRESHEVËS ËSHTË KRITIKE** F.5

**PROMOVOHET "SHTEGU I SHËNETIT" 8.9 KM NË PARKUN GËRMIA** F.6

## EKONOMI



**KURTI: FONDI SOVRAN DO TË REZULTOJË ME NJË STABILIZIM TË EKONOMISË PËRMES DIVERSITETIT** F.7

**ASK-ja: RRETH 100 MIJË TË RINJ NË KOSOVË JANË TË PAPUNË, PA SHKOLLË DHE NUK NDJEKIN TRAJNIME PROFESIONALE** F.7

## DOSSIER



**BALLKANI MPOSHTI DRITËN, LUFTA PËR TITULL BËHET DRAMATIKE** F.10

## KURTI: EKIPI MENAXHUES PËR HARTIMIN E DRAFT-STATUTIT TË ASOCIACIONIT PËRFUNDOI MISIONIN DHE FUNKSIONIN E VET

FAQE 3



**KRASNIQI: MAQEDONIA PO LIDH TROJET SHQIPTARE ME AUTOSTRADËN MODERNE, I NJËJTI RITËM I PUNËS S'PO NDODH NË KOSOVË** F.5

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Pa sukses në fushëbetejë, ndihmat për Ukrainën mund të vihen në rrezik

**KIEV, 7 MAJ** - Në vijat e frontit në Ukrainë nuk ka pasur shumë lëvizje prej se forcat e vendit kanë çliruar qytetin e Hersonit nga ushtria pushtuese ruse nëntorin e kaluar. Por, presidenti Volodymyr Zelensky ka thënë se ushtria e tij është tani gati të nisë një kundërofensivë të re. Ai nuk ka specifikuar se kur, por ka thënë se nuk mund të zvarritet pafundësisht. "Ne jemi të aftë t'i japim fund kësaj lufte. Por, jo gjithçka do të ndodhë menjëherë - nesër. Na duhet kohë për t'u stërvitur, por e dimë se si ta bëjmë më shpejt", ka thënë Zelensky.

Ushtria ukrainase është duke trajnuar dhjetëra mijëra trupa të reja - disa prej tyre në kampe në ShBA dhe në vende të ndryshme të Evropës - që pritet të marrin pjesë në ofensivën e pranverës. Kievi ka marrë, gjithashtu, grumbuj armësh të prodhimit perëndimor, përfshirë tanke Leopard dhe Challenger. Njësitë e tij, të rregullta dhe të parregullta, do të hyjnë në ofensivë me më shumë se 32 miliardë dollarë armë nga arsenalet e ShBA-së - plus miliarda të tjera nga aleatët evropianë.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se "mbi 98 për qind" e automjeteve ushtarake që i janë premtuar Ukrainës janë dorëzuar. "Në total, ne kemi trajnuar dhe pajisur më shumë se nëntë brigada të reja ukrainase. Kjo do ta vendosë Ukrainën në një pozicion të fortë për ta vazhduar rimarrjen e territorit të pushtuar", ka thënë Stoltenberg. Rusia ka mbledhur, gjithashtu, forca që do të përpiqen ta thyejnë mbrojtjen ukrainase në rajonin lindor të Donjeckut. Ajo po kryen edhe një fushatë të re rekrutimi, ndërsa ka zgjeruar tashmë linjat e saj mbrojtëse - me fusha të minuara e llogore. "Thirrja për rekrutim, e cila ka filluar më 1 prill, po zhvillohet sipas planit dhe do të përfundojë më 15 korrik. Deri më tani 52 mijë qytetarë kanë marrë urdhra dhe më shumë se 50 mijë janë paraqitur në zyrat e regjistrimit ushtarak", ka thënë udhëheqësi i mobilizimit ushtarak në Rusi, Andrey Biryukov.

Megjithatë, Instituti për Studime të Luftës, me seli në Uashington, e nxjerr Rusinë të dobësuar. Në një hulumtim që ka publikuar më 23 prill thuhet se "ka shumë gjasa" që "shumica e elementëve rusë në Ukrainë të jenë nën kapacitetet e plota për shkak të humbjeve që kanë



pësuar gjatë fazave të mëparshme të luftës". "Rusët kanë probleme të mëdha me mbledhjen e forcave", thotë për programin "Expose" të "Radios Evropa e Lirë", George Barros, një prej autorëve të hulumtimit. "Kur presidenti rus Vladimir Putin ka shpallur mobilizim të pjesshëm shtatorin e kaluar, 700 mijë rusë janë larguar nga vendi, sepse e kanë kuptuar se ushtria ruse ka humbur më shumë pajisje dhe njerëz në Ukrainë brenda një viti sesa që kanë humbur sovjetikët gjatë një dekade në Afganistan. Pra, është një narrativë shumë e njohur tashmë, se Ukraina është vendi ku të rinjtë dhe të moshuarit rusë shkojnë për të vdekur", thotë Barros.

Ai shton se një tjetër dallim midis betejave të vitit të kaluar dhe luftimeve sot është se makineria luftarake ruse është, po ashtu, e dobësuar. Nga 20-30 mijë predha në ditë, sa ka hedhur verën e kaluar, ajo sot gjuan rreth 10 mijë.

Mark Cancian, kolonel i pensionuar i ushtrisë amerikane, pajtohet, por shton se nuk duhet minuar kapacitetet e ushtrisë ruse. "Shumë prej trupave ruse nuk janë të trajnuara mirë dhe nuk janë të motivuara mirë. Megjithatë, duhet qenë i kujdesshëm këtu, sepse rusët janë ende në fushëbetejë, kanë luftuar tash e 14 muaj dhe nuk duket se do të dorëzohen", thotë Cancian për "Exposenë".

Se ku edhe kur do të nisë kundërofensiva, autoritetet në Kiev e mbajnë sekret. Cancian thotë se ajo mund të nisë në Zaporizhja - njërin prej katër

rajoneve ukrainase, të cilin presidenti rus, Vladimir Putin, e ka shpallur të aneksuar në shtator të vitit 2022. Sipas tij, shtyrja e mëtejshme e ofensivës mund t'i japë Rusisë kohë për t'u konsoliduar dhe për t'i forcuar më shumë pozicionet e saj. "[Ukrainasit] janë mjaft gati. Kanë marrë shumë pajisje gjatë 14 muajve të fundit. Kanë bërë trajnime në Evropë, trajnime bazë, trajnime në njësi dhe sigurisht trajnime për pajisjet. Por, ushtritë nuk janë kurrë aq të gatshme sa duan të jenë.

Gjithmonë kërkohen më shumë pajisje, më shumë trajnime. Pra, është ajo ndjenja se nuk janë gati, se nuk do të jenë kurrë plotësisht gati. Por, duhet ta keni parasysh se kjo është një garë me rusët, se rusët po përgatiten gjithashtu. Po forcohen, po bëjnë përgatitjet e tyre. Pra, pritja ka shumë rrezik", thotë Cancian. Ukraina është nën presion në rritje për të treguar rezultate në fushëbetejë, pasi disa mbështetës të saj perëndimorë kanë nisur të tregojnë shenja mosdurimi. Franca, për

shembull, përmend vazhdimisht një lloj armëpushimi ose negociata të paqes midis Rusisë dhe Ukrainës.

Në Britani, udhëheqësi i grupit parlamentar për Ukrainën, Robert Seely, ka thënë se "nëse luftëtarët ukrainas nuk arrijnë të bëjnë përparim deri në fund të verës, zërat në Perëndim që bëjnë thirrje për një zgjidhje të negociuar, ose që argumentojnë kundër mbështetjes për Ukrainën, do të rriten".

Në Shtetet e Bashkuara sondazhet e opinionit publik tregojnë, po ashtu, zbehje të entuziazmit për armatosjen e Ukrainës.

Gazeta "New York Times" ka shkruar se ofensiva pranverore në Ukrainë do të vijë me "rreziqe të mëdha për të ardhmen e luftës". "Pa një fitore vendimtare, mbështetja perëndimore për Ukrainën mund të dobësohet dhe Kievi mund të vihet nën presion në rritje, për të hyrë në bisedime serioze të paqes, për t'i dhënë fund ose për ta ngrirë konfliktin", ka shkruar "New York Times".

Udhëheqësit ukrainas thonë se duan t'i çlirojnë të gjitha territoret e pushtuara nga Rusia - përfshirë Krimenë dhe territoret e tjera që janë okupuar nga Moska në vitin 2014 - pavarësisht faktit se shumë zyrtarë amerikanë dhe evropianë i konsiderojnë këto ambicie si joreale.



## Kurti: Ekipi menaxhues për hartimin e draft-statutit të Asociacionit përfundoi misionin dhe funksionin e vet

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për medie ka thënë se ekipi menaxhues për hartimin e draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe e ka përfunduar misionin dhe funksionin e tij. Kurti ka thënë se lirimi nga detyra e këtij ekipi ka qenë vendimi më i drejtë që është marrë. “Ekipi menaxhues ka përfunduar edhe misionin dhe funksionin e vet, andaj ne nuk kemi më arsye ta dëgjojmë ekipin menaxhues, sepse çfarë pati për të thënë e tha në Bruksel më 2 maj. Edhe lirimi nga detyra është gjëja më e natyrshme dhe

më e logjikshme”, ka thënë ai. Gjatë konferencës Kurti theksoi se ende nuk kanë marrë ndonjë përgjigje për propozimin e draft statutit të Asociacionit. “Shkuam në Bruksel, e dëgjuam prezantimin e draft statutit - prezantuan vetëm thelbin e statutit, pastaj na përcollën të plotë. Nga neni kuptohet që është dëshira e madhe për një Republikë Srpska në Kosovë. Shprehim mospajtimin fundamental me këtë propozim. Unë e dhashë një propozim timin se si duhet të rregullohet neni 7 i marrëveshjes që kemi bërë. Ndërmjetësit nuk dhanë vlerësim për atë, mirëpo pala serbe nuk pranoi as ta marrë për lexim. Ne e kemi dëgjuar ekipin

menaxhues. Ne e kemi lexuar propozimin e tyre. Ne kemi dhënë mendimin tonë mospajtues, ndërsa për propozimin tonë nuk kemi përgjigje nga ndërmjetësi”, u shpreh ai.

Kryeministri tha se për propozimin e tij është inspiruar nga modeli i Kroacisë. “Ky draftvizion që e kam prezantuar unë aty është i inspiruar nga modeli i Kroacisë për pakicat kombëtare, përkatësisht për pakicën serbe. Marrëveshjen për modelin për mbrojtjen e pakicës serbe në Kroaci e ka pranuar edhe Serbia, prandaj ne kemi konsideruar që ky është vendi që ne do të mund ta marrim frymëzimin tonë. Nëse Serbia e



ka pranuar këtë gjë me Kroacinë, konsiderojmë se do të duhet ta pranojmë edhe me ne. Nuk jam i interesuar as t'i kontrolloj serbët, as t'ia shkel të drejtat asnjë minoriteti, asnjë qytetari të

republikës. Në veçanti për nenin 7 të marrëveshjes bazë kam ofruar një draftvizion që shpresoj se do të marrë një vlerësim nga ndërmjetësit evropianë”, ka deklaruar Kurti.

## Ushtrimi i madh ndërkombëtar ushtarak në Kosovë, test për FSK-në

PRISHTINË, 7 MAJ - Në prag të ushtrimit “Defender Europe '23” përgatitjet janë duke vazhduar me intensitet të shtuar. Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, e ka përgëzuar Shtabin e FSK-së, partnerët tanë dhe të gjithë ata që janë duke u angazhuar maksimalisht, që ky ushtrim të jetë në nivelin më të lartë organizativ.

Ministri Mehaj theksoi se Ushtria e Kosovës do të jetë pjesë e NATO-s dhe në bazë të standardeve të saj është duke u forcuar çdo ditë e më shumë. “Ky ushtrim do të jetë një test i radhës për Ushtrinë e Kosovës, në të cilin do të përgatiten kapacitetet tona luftarake”, u shpreh ministri Mehaj, duke shtuar se Kosova në NATO është amanet i dëshmorëve tanë.




## Osmani, Konjufca dhe Kurti kujtojnë betejën e Çabratit: Dëshmorët, vula e përjetësisë së shtetit

GJAKOVË, 7 MAJ - Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë përkujtuar 24-vjetorin e betejës së Çabratit. Osmani ka potencuar se dëshmorët e UÇK-së janë vula e përjetësisë së shtetit dhe “do t'i kujtojmë përherë me respekt”. “26 luftëtarë të Brigadës 137 ‘Gjakova’, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 24 vjet më parë ranë heroikisht në Betejën e Çabratit, në përpjekjen e tyre për t'u dalë në ndihmë bashkëqytetarëve të tyre, të cilët tri ditë rresht iu nënshtruan veprimeve kriminale të regjimit gjencoidal të Serbisë. Rreth 100 banorë civilë u vranë në mënyrë mizore nga makineria

gjenocidale serbe, mbi 300 u rrëmbyen me dhunë, teksa lufta për mbrojtjen e pragut të shtëpisë kishte marrë hov gjithandej, afro një muaj përpara se Kosova të bëhej e lirë. Dëshmorët e UÇK-së janë vula e përjetësisë së shtetit tonë dhe do t'i kujtojmë përherë me respekt!”, është shkruar në deklaratën e Osmanit.

E kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se është vështirë të përmbledhet në pak rreshta krimi i gjenocidit kryer nga forcat ushtarake dhe policore të Serbisë në qytetin e Gjakovës, ku vetëm më 7, 8 dhe 9 maj 1999 u vranë 41 civilë dhe 43 të tjerë u rrëmbyen dhe zhdukën me dhunë.



### EPOPEJA E ÇABRATIT

7 maj 1999 - GJAKOVA MBROJTI NDERIN

Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se kujtojmë çdo ditë sakrificat e mëdha që janë bërë për çlirimin e vendit.

“Mëngjesin e 7 majit të vitit 1999, Çabrati i Gjakovës agoi nën rrethimin e forcave të shumta të Serbisë. Në mbrojtje

të civilëve doli Brigada 137 “Gjakova”. Luftimet e ashpra mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave serbe vazhduan deri më 11 maj. Në këto ditë maji të vitit 1999, në Çabrat e në rrethinat e qytetit, ranë 26 dëshmorë e më shumë se 100 martirë. Mbi 350 civilë të moshave të ndryshme u rrëmbyen me dhunë. Shumë prej tyre u mbajtën peng në burgje të ndryshme. Sot kujtojmë djemtë dhe vajzat që luftuan në betejën e Çabratit. Kujtojmë çdo ditë sakrificat e mëdha për çlirim! I përjetshëm qoftë kujtimi për 1 022 martirët dhe 361 ushtarët dëshmorë të Gjakovës!”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.



## Asociacioni, “kusht mbi kushtet”

**PRISHTINË, 7 MAJ** - Themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë është “kusht mbi të gjitha kushtet” në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve. Pa përparim në këtë pikë “nuk mund të ketë përparim as në çështjet e tjera” për të cilat diskutohet në këtë dialog. Kështu thonë disa burime diplomatike në Bruksel, duke pranuar, ndonëse jozyrtarisht, se Asociacioni është prioriteti numër një, edhe pse Marrëveshja e Ohrit midis Kosovës dhe Serbisë, që duhet të shpjerë në normalizimin e marrëdhënieve mes tyre, duhet zbatuar plotësisht.

Për themelimin e këtij asociacioni Kosova dhe Serbia kanë arritur një marrëveshje në vitin 2013, por ajo nuk është zbatuar kurrë. Beogradi ka insistuar në kompetenca të gjera për këtë asociacion, ndërsa Prishtina i ka kundërshtuar ato, duke thënë se mund ta rrezikojnë funksionalitetin e shtetit.

Në BE thonë se hapi i parë drejt themelimit të Asociacionit është bërë me paraqitjen e draft-statutit të tij, këtë javë në

Bruksel, edhe pse palët kanë shprehur qëndrime shumë të kundërta në lidhje me atë dokument.

Drafti-statuti u paraqit nga një ekip menaxhues, i përbërë nga katër pjesëtarë të komunitetit serb, gjatë një takimi midis kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, më 2 maj në Bruksel.

Kurti tha se ky dokument është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, ndërsa Vuçiq e kritikoi Kurtin që nuk po e zbaton “obligimin e dhjetë vjetëve më parë”. Për BE-në, sipas fjalëve të një zyrtari të lartë, as teksti i këtij drafti e as reagimi i palëve ndaj tij nuk kanë qenë befasi.

Ky draft është përgatitur qysh nga viti 2018, por deri më tani nuk ka pasur pajtim mes palëve që ai të prezantohet në ndonjë takim të nivelit të lartë. Kjo, sipas burimeve të BE-së, është bërë e mundshme vetëm pas Marrëveshjes së Ohrit, e cila është arritur në mars.

Për BE-në, ndërkaq, prezantimi i draft-statutit ka “rëndësi edhe simbolike, edhe përmbajtësore”. “Nuk e kishim

parë dokumentin para prezantimit. Por, nuk ishte befasi për ne, sepse kishim dëgjuar qëndrimet e palëve më herët. Ishte propozim për kompetenca shumë të gjëra ekzekutive. Dhe, për ne nuk ishte befasi që Kurti e refuzoi. Kurti prezantoi propozimin e tij, krejt të kundërt nga drafti i Ekipit Menaxhues. Asgjë e papritur nuk ishte as kjo. Tani duhet të tentojmë t'i tejkalojmë dallimet mes palëve. Prandaj, prezantimi nuk ishte akt në vete, por nisje e një procesi të domosdoshëm”, thotë një zyrtar i lartë i BE-së.

Ai paralajmëron se ekspertët dhe kryenegociatorët në dialog tashmë janë ftuar të shkojnë në Bruksel dhe të vazhdojnë të diskutojnë në mënyrë që të krijohen kushtet për një kompromis. Data për këtë takim është duke u diskutuar mes ndërmjetësuesve nga BE-ja dhe delegacionit të Kosovës dhe atij të Serbisë.

Sipas zyrtarit të lartë të BE-së, “diskutimet duhet të bazohen në marrëveshje dhe në praktika të mira evropiane”. “Procesi është jashtëzakonisht i rëndësishëm për fatin e dialogut. Pa pajtim rreth statutit dhe pa formimin e

Asociacionit nuk mund të ketë sukses në dialog”, thotë ky zyrtar i lartë.

Vendosja e çështjes së krijimit të Asociacionit si “kusht mbi të gjitha kushtet”, megjithatë, bie ndesh me një pikë të aneksit për zbatimin e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve - për ç'gjë palët janë pajtuar në Ohër më 18 mars.

Aty thuhet se renditja e pikave nuk reflekton edhe renditjen e prioritetëve dhe se të gjitha pikat kanë të njëjtën rëndësi. Por, përkundër kësaj, jo vetëm zyrtarë të lartë të BE-së, por edhe ata të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në secilën paraqitje publike, përmendin më së shumti krijimin e Asociacionit si prioritet kryesor.

Sipas një zyrtari të lartë të BE-së, nisja e procesit të themelimit të Asociacionit, që sipas Brukselit ndodhi në takimin e 2 majit, dëshmoi se sa larg janë palët nga njëra-tjetra. Sipas tij, ky takim tregoi se “kimia mes dy liderëve nuk është e mirë”.

Bashkimi Evropian bëri tentime ta sqarojë edhe mënyrën e formimit të “Ekipit Menaxhues” dhe rolin e tij. BE-ja doli kundër interpretimeve të Kosovës se “me

paraqitjen e draft-statutit, Ekipi Menaxhues e përfundon punën e vet dhe mund të shuhet”. Sipas BE-së, “vendimi për shuarjen e Ekipit Menaxhues shkel edhe tekstin, edhe frymën e marrëveshjes” dhe ai ekip duhet të ekzistojë derisa të miratohet statuti i Asociacionit. BE-ja tha, po ashtu, se “Ekipi Menaxhues” ishte si një “delegacion në vete” në takimin e nivelit të lartë në Bruksel dhe se nuk ishte “as në delegacionin e Serbisë, as në atë Kosovës”. Sipas BE-së, formimi i këtij ekipi, po ashtu, është i sqaruar në marrëveshje dhe ai përbëhet nga persona që i propozon Serbia, por formalisht i emëron Qeveria e Kosovës.

Koordinatorja e këtij ekipi që udhëtoi në Bruksel për ta paraqitur draft-statutin është edhe deputete e Kuvendit të Serbisë. Për këtë, kryeministri i Kosovës, Kurti, tha se ajo “është në konflikt interesi”.

Në BE pranojnë se dallimet rreth Asociacionit nuk do të jenë të lehta për t'u tejkaluar. Me gjithë vështirësitë, në BE këmbëngulin që të ketë një zgjidhje sepse, në të kundërtën, siç përsëritin, dialogu nuk mund të ecë përpara./REL

# Krasniqi: Maqedonia po lidh trojet shqiptare me autostradën moderne, i njëjti ritëm i punës s'po ndodh në Kosovë

**EPOKA ERE** **Faton DËRMAKU**


PRISHTINË, 7 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se është lajm shumë i mirë fillimi i projektit për ndërtimin e korridorit 8 në

Maqedoni të Veriut - autostradës moderne që pritet t'i lidhë vendbanimet shqiptare prej Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Bokuçanit, Strugës e deri në Qafëthanë. Krasniqi ka thënë se kjo autostradë me gjashtë korsi, me një gjatësi prej 68 kilometrave,

do të ndikojë jashtëzakonisht shumë në lidhjen, afrimin dhe fuqizimin e shqiptarëve të cilët jetojnë nëpër këto qytete. "Përgëzoj faktorët politikë shqiptarë në Maqedoni të Veriut, në krye me kryetarin e BDI-së, Ali Ahmeti, por edhe zëvendëskryeministrin Artan

Grubi, të cilët po bëjnë një punë shumë të rëndësishme për shqiptarët që jetojnë atje", ka shkruar Krasniqi në "Facebook". Ai ka thënë se, fatkeqësisht, të njëjtin ritëm të punës dhe zhvillimit nuk po e përjetojmë në Kosovë. "Qeveria e cila është

zgjedhur për të punuar, me përjashtim të urës trimetërshe në Saradran të Istogut, ka vendosur ta kalojë mandatin e saj pa asnjë projekt që përmirëson konkretisht dhe denjësisht jetën e qytetarëve tanë", ka theksuar lideri i PDK-së, Memli Krasniqi.



## Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë i shkruan KiE-së: Situata e shqiptarëve në Luginë të Preshevës është kritike

PRISHTINË, 7 MAJ - Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë (KASH), i ka dërguar një letër Këshillit të Evropës (KiE), me anë të cilës shpreh shqetësimin se situata e shqiptarëve të Luginës së Preshevës është kritike. "Një spastrim etnik modern me të drejtë quhet pasivizimi i adresave, i cili realizohet me ligj dhe që u mundëson autoriteteve shtetërore serbe t'i çregjistrojnë nga regjistri civil banorët e Luginës, të cilët në një kohë të caktuar nuk gjenden në shtëpitë e tyre", është thënë në letër.

Sipas KASH-it, procesi i verifikimit është i njëanshëm dhe diskriminues, ndërsa vetë zbatimi i ligjit është jashtëzakonisht diskriminues i kryer vetëm në dëm të pakicës shqiptare në Serbi. "Pasivizimi i adresave ka pasoja direkte negative për përditshmërinë e

shqiptarëve. Më tej, ai sjell shpopullimin e Luginës nga shqiptarët dhe heqjen e të drejtës së votës. Janë mijëra shqiptarë të Luginës të cilëve tashmë e drejta e votës dhe e qëndrimit u janë hequr nga regjistrat shtetërorë civilë të Serbisë.

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë do të përgatisë dhe dërgojë letra, bazuar në gjetjet e tij nga vizita në terren, edhe organizatave dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare që merren me të drejtat e njeriut dhe të pakicave kombëtare, me qëllim ushtrimin e presionit për t'i siguruar të drejtat e shqiptarëve që jetojnë në Serbi", është thënë në letërën e Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë (KASH), kryetar i të cilit është Besnik Mustafaj, njëherësh ish-ministër i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë.



## Promovohet "Shtegu i shëndetit" 8.9 km në parkun Gërmia

PRISHTINË, 7 MAJ - Përfaqësues të komunës së Prishtinës së bashku me Shoqatën e Kardiologëve të Kosovës, Klubin Alpin Prishtina, USAID dhe qytetarët, kanë ecur drejt parkut Gërmia duke promovuar "Shtegun e

shëndetit". Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka shkruar se po përfundojnë javën me plot aktivitete të realizuara në kuadër të "Javës Ndërgjegjëse për

Pamjaftueshmëri të Zemrës" në kryeqytet. "Përmes këtij shtegu promovojmë rëndësinë që ka aktiviteti fizik në shëndetin e njeriut. Prishtina po frymon lirshëm", ka shkruar Rama.



## Haradinaj përkujton dëshmorët e Gjakovës dhe heroin Bahri Fazliu

GJAKOVË, 7 MAJ - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kujtuar të dielën betejën e Brigadës 137 "Gjakova" si dhe heroin e kombit, Bahri Fazliu, në 25-vjetorin e rënies.

Haradinaj ka thënë se armiku për hakmarrje ndaj humbjeve në frontin e luftës nuk i kishte kursyer as civilët. "Beteja urbane e Brigadës 137 'Gjakova' është unike në historinë çlirimtare të Kosovës. Bijtë e bijat e Gjakovës ishin shembulli më i mirë i luftëtarëve të lirisë, që nga mobilizimi i tyre në ditët e para të luftës për liri e deri te formimi i Brigadës dhe dita e fitores. Armiku për hakmarrje ndaj humbjeve në frontin e luftës nuk kursou civilët e pafajshëm tek Ura e Taliqit. 13 shqiptarë të

pafajshëm po të njëjtën ditë u ekzekutuan edhe në Ozdrim të Pejës, fshat që u mobilizua që nga filltet e luftës për liri", ka shkruar Haradinaj.

Haradinaj ka kujtuar edhe heroin e kombit Bahri Fazliu në përvjetorin e rënies. "Po ashtu, në muajt e përvjetorëve të heronjve dhe të dëshmorëve, sot kujtojmë njërin prej figurave të rëndësishme të luftës për lirinë e Kosovës, Bahri Fazliu. Vendosmëria dhe trimëria, si dhe sakrifica e skajshme e Bahri Fazliut, më parë edhe e Fahri Fazliut dhe Afrim Zhitisë, i ngrit ata në pedestalin e dëshmorëve të Kosovës. Përgjithmonë krenarë me heronjtë e ushtrisë çlirimtare! Përgjithmonë krenarë me rrugëtimin tonë për liri", ka shkruar Haradinaj.



## Hoti: Ura mbi Drinin e Bardhë paraqet rrezik për qarkullim, qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë veprim



Prishtinë, 7 maj - Dy deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti dhe Driton Selmanaj, kanë vizituar urën mbi Drinin e Bardhë në Rogovë të Hasit. Hoti ka deklaruar se kjo urë paraqet rrezik për qarkullim dhe se deri tani qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë veprim. Sipas Hotit, qeveria ka bllokuar edhe disa projekte kapitale në Kosovë. "Ura mbi Drinin e Bardhë në Rogovë të Hasit është dëmtuar nga reshjet në janar 2021. Sipas komisionit të Ministrisë së Infrastrukturës, ura paraqet rrezik për qarkullim. Bashkë me deputetin z. Driton Selmanaj dhe anëtarët e degës së LDK-së në Gjakovë pamë se asnjë veprim nuk është ndërmarrë deri më sot. Para se të jetë vonë edhe një herë bëj thirrje të trajtohet me prioritet ky rast", ka shkruar Hoti në "Facebook". Ai ka deklaruar se është e pakuptueshme bllokada e

projekteve kapitale në gjithë Kosovën: autostrada për Gjiilan, rruga për Podujevë, rruga për Mitrovicë, rruga për Gjakovë, rruga Xërxë-Rahovec e shumë projekte të tjera.

Deputeti Hoti ka pohuar se "dëmet për qytetarë dhe për ekonominë nga vonesa në këto projekte të mëdha janë së paku tri herë më të mëdha se kostoja e këtyre projekteve, një shifër që shkon në 1 miliard euro". "Tanimë është e qartë se kjo qeveri nuk i ka prioritet këto projekte dhe nuk do t'i kryejë në mandatin e mbetur prej një viti e gjysmë. Kjo shihet edhe nga raportit i buxhetit për periudhën janar-mars 2023, ku pothuajse të gjitha projektet kapitale janë me shpenzime zero. Për më tepër, jo vetëm që nuk i shpenzon mjetet e veta, por qeveria i ka bllokuar edhe shumë projekte të komunave duke mos ua bartur mjetet vetjake", ka thënë Hoti.


## Sërish shfaqen simbolet e agresionit rus në Kosovë

PRISHTINË, 7 MAJ - Shkronja "Z", që simbolizon agresion rus mbi Ukrainën, është shfaqur sërish në tokën e Kosovës. Eksperti i sigurisë, Agim Musliu, përmes një postimi në "Facebook", thotë se kësaj radhe simbolet e agresionit rus janë paraqitur në një majë në Grabovc, afër Zveçanit. Ai thotë se tashmë për këto mbishkrime përgjegjësinë e

ka marrë e ashtuquajtura "Severna Brigada". "Simboli i agresionit rus në Ukrainë dhe flamuri i Serbisë janë vendosur sot në një majë në Grabovc, afër Zveçanit. Ata që kanë marrë përgjegjësinë e këtij akti provokativ është e ashtuquajtura 'Severna Brigada', e udhëhequr nga nënkryetari i Listës Serbe, Milan Radoičiq, njeriu

kryesor i Aleksandër Vuçiqit në Kosovë", ka shkruar Musliu. Edhe në të kaluarën në disa ndërtesa në Mitrovicën e Veriut në Kosovë janë vizatur simbole të ushtrisë ruse që përdoren në luftën në Ukrainë. Shkronja "Z" është shfaqur në ndërtesa publike dhe sheshe. Në Rusi shkronja "Z"

përdoret si simbol i pushtimit ushtarak. Ukraina u ka bërë thirrje shteteve që ta dënojnë penalisht përdorimin e simbolit "Z", i cili konsiderohet mbështetje për ushtrinë ruse. Në Gjermani disa lande e kanë ndaluar përdorimin e kësaj germe duke parashikuar dënime për ata që e përdorin.



# Kurti: Fondi Sovran do të rezultojë me një stabilizim të ekonomisë përmes diversitetit

**EPOKA ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 7 MAJ - Kryeministri i vendit, Albin Kurti, sot në konferencën e lansimit të Fondit Sovran të Kosovës, ka thënë se Kosova është afër themelimit të këtij fondi. Kurti ka thënë se para gjashtë vjetëve, në zgjedhjet e qershorit 2017, për herë të parë dolën me propozimin dhe zotimin për themelimin e Fondit Sovran si organizim ku do të inkorporoheshin dhe menaxhoheshin ndërmarrjet dhe pasuritë publike të

Republikës së Kosovës. “Ky projekt e zotim yni i madh, hap pas hapi e sigurt, po merr formë e jetë. Sot do të flasim për themelimin e Fondit Sovran. Tani kur projektligji ka kaluar konsultimet publike, jemi një hap më afër drejt miratimit të tij e, me këtë, të kurorëzimit të idesë që ka nisur me koncept dokumentin mbi Fondin Sovran të udhëhequr nga profesor Besnik Pula gjatë vitit të kaluar”, është shprehur Kurti.

Ai ka thënë se kjo qeveri qëndron fuqishëm mbrapa këtij vizioni, duke besuar se një nismë

e këtillë do të rezultojë me stabilizim të ekonomisë përmes diversitetit, krijim të profitit për shtetin përmes investimeve të mençura e me gjenerim të pasurisë për gjeneratat që vijnë. “Të gjitha këto, pra me qëllim të një transformimi makroekonomik, të bazuar në kornizë politikash të investimeve të qarta, përmes dispozitave ligjore të parashikueshme”, është shprehur Kurti, duke shtuar se ndërmarrjet tona publike do të bëhen pjesë integrale e Fondit, me qëllim të mundësisë për rritje të investimeve të nevojshme për

zhvillim ekonomik. “Gjatë qeverisjes sonë dyvjeçare kemi shënuar rezultate signifikante në ekonomi”, ka deklaruar Kurti. Ai ka thënë se krahas fuqizimit të ndërmarrjeve publike, kanë punuar në rritjen ekonomike e cila ka një mesatare prej 7-përqindësh në dy vjetët e fundit e që, sipas kryeministrit, është më e madhja që nga paslufta. “Kemi rritur eksportet për 83.6 për qind e 47.6 për qind investimet e huaja direkte. Trendin e këtillë e vazhdojmë me 25 mijë vende të reja pune, numër ky që po rritet çdo ditë

përmes platformës së re ‘Superpuna’. Kemi rregulluar pagat në sektorin publik e kemi shënuar përparim në luftën kundër korrupsionit, duke u rritur për 22 vende sipas Transparency International. Luftën kundër korrupsionit e vazhdojmë me strategjinë kundër korrupsionit që do të hartohet këtë vit e me agjendë të pasur legislative që shënon ndryshim rrënjësor në luftim të korrupsionit përmes themelimit të Byrosë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme”, ka thënë Kurti.



## ASK-ja: Rreth 100 mijë të rinj në Kosovë janë të papunë, pa shkollë dhe nuk ndjekin trajnime profesionale

PRISHTINË, 7 MAJ - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ditë më parë ka njoftuar se mbi 740 mijë persona në vend janë ekonomisht joaktivë, që nuk janë në punë dhe aktualisht nuk janë të regjistruar në ndonjë nga zyrtar shtetërore që kërkojnë punë.

Nga të dhënat që i përkasin periudhës së tremujorit të parë të vitit 2022, më shqetësues mbetet numri prej 100 mijë, prej tyre të moshës nga 15 deri në 24 vjeç, që përpos se janë të papunë, nuk janë as në shkollë dhe nuk ndjekin trajnime profesionale.

Të dhënat e ASK-së tregojnë se janë mbi 1.2 milion qytetarë në moshë pune, mbi 380 mijë janë të punësuar, mbi 77 mijë janë të papunë dhe mbi 750 mijë janë

ekonomikisht joaktivë.

Nga komuniteti i biznesit thonë se qytetarët e cilësuar në masë të madhe si pasivë nuk regjistrohen për të kërkuar punë për shkak se këto institucione nuk kanë arritur t’u përgjigjen kërkesave të tyre ndërsa, ndryshe nga vendet e tjera, as nuk kanë ndonjë mbështetje financiare gjatë kohës së pritjes për punësim.

Duke folur për numrin prej rreth 100 mijë të rinjsh, kryeshefi i ASK-së, Ilir Berisha, thotë se të ata mbahen nga familja dhe nuk kanë bërë ndonjë kërkesë që të kyçen në tregun e punës. “Personat joaktivë dhe ata që nuk kërkojnë punë në Kosovë gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 ishin mbi 740 mijë, prej këtyre 98 mijë e 271 janë të rinj. Të gjitha këto janë



rezultate të anketës të fuqisë punëtore që bazohen me një mostër dhe kornizë e mostrës janë të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 me ndryshime demografike dhe ende konsiderojmë se këto rezultate në të ardhmen do të ndryshojnë pasi të bëhet regjistrimi i këtij viti, pasi konsiderojmë se popullsia

rezidente nuk është siç e kemi në kornizën aktuale”, thekson Berisha. Ai derisa rendit disa nga faktorët që ndikojnë që një pjesë e madhe e të rinjve janë papunë, shkollë e trajnime, pranon se numri i personave që nuk kërkojnë punë është duke u rritur. Drejtori i Odës Ekonomike

Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, vlerëson se roli i trupave që ofrojnë mundësi punësimi është zbehur. Zeka thotë se pavarësisht se ka kërkesë të madhe për punëtorë në sektorin privat, ka një boshllëk të disponueshmerisë së fuqisë punëtore.

Shifra e lartë e të rinjve pasivë konsiderohet rrezik për vendin, thotë kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Atdhe Hykolli. Ai thotë se institucionet duhet të kenë një qasje serioze ndaj këtij fenomeni. Mes të tjerash, Hykolli shton se si BSPK vazhdimisht janë në kontakt me të punësuarit dhe po përpiqen t’ua ofrojnë kushtet elementare që të rinjtë të duan t’i shërbejnë këtij vendi. (ksp)

# E Vërteta: Pavarësia e Kosovës, Amerika dhe Diaspora! Një libër i veçantë dhe Ekrem Bardha që nuk njihja



Nga Bedri ISLAMI

Mendimi i parë që të vjen në mendje, ndërsa lexon librin e fundit të zotit Ekrem Bardha, “E vërteta, pavarësia e Kosovës, Amerika dhe diaspora” qëndron në faktin se sa pak kemi ditur për atë që ka ndodhur me një brez të shkëlqyer atdhetarësh, përgjithësisht larg Shqipërisë, të cilët, si pak kush, kanë bërë shumë më tepër nga sa mund të merret me mend.

Ka qenë thujtja e panjohur për ne bota e tyre, ndërtuar në një mënyrë krejt të veçantë, që, edhe pse në një kontinent tjetër, ata e sollën atdheun pranë vetes, krijuan atdheun e tyre, i cili nuk ishte vetëm ai që njohim, me malet, lumenjtë, hapësirat e luginave dhe rrafshnaltat, por shumë më tepër se kaq.

Ata ndërtuan atdheun e ideve, vizioneve, përkushtimeve, sakrificave, mendimit për të ardhur drejt tokës së bekuar nga e cila ishin larguar, ata vetë apo prindërit e gjyshërit e tyre.

Zoti Bardha është një ndër figurat më të shquara të diasporës

shqiptare, jo vetëm në Amerikë, i ka bërë vend vetes me përkushtimin që ka treguar, duke sjellë dëshmi jete, më parë se t'i bënte dëshmi të një libri.

E pamundur ka qenë që ngjarjet famë mëdha të fund-shekullit të shkuar, që sollën rilindjen e kombit dhe pavarësinë e shtetit të Kosovës, pa pasur përkushtimin maksimal do të thosha të pa kund shoq, që ndërmorën shqiptarët përtej Atlantikut, jo vetëm në një vit a dy, jo vetëm një brez i veçantë, por disa gjenerata, të cilët bënë një histori të pa zakonit.

Një rën nga këto histori e sjell edhe Ekrem Bardha në librin e tij të fundit. E sjell me vërtetësi, qartësisht të besueshme, plot kolorit dhe përmes ngjarjeve, ajo që dikur ishte e largët, bëhet e afërt, e natyrshme dhe mbi të gjitha, historike.

\*\*\*\*

Kur ata që i kanë përjetuar vetë ngjarjet, pra, që kanë qenë pjesë e tyre, i kanë mbrujtur dhe i kanë

dhënë jetë, heshtin, pikërisht atëherë lindin legjendat dhe moskuptimet. Ndryshe ndodh kur bëhen dëshmuar të asaj që ka ndodhur, rrëfejnë një pjesë të jetës së tyre dhe risjellin vitet e kujtesës me pasionin e të vërtetës.

Fundi i shekullit të shkuar në Shqipëri ishte ndoshta më përmbyesësi në historinë e këtij vendi; mitet ranë rrëmuqshëm shpejt dhe dritësimi erdhi nga një lëvizje që nuk mund të mendohej ndryshe. Vlerësimi për njerëzit dhe për ngjarjet nisi të ndryshojë mrekullisht, tabutë ranë, nisi një frymëmarrje ndryshe që, megjithëse e shpeshtuar dhe marramendëse, përsëri ishte dehmë lirie, duke u saktësuar e vërteta në ato përmasa që mund të ishte, edhe pse nganjëherë do të dukej e shpërfytyruar; fjalitë që kishin mbetur në mes, mendimet, ndjenjat, përfytyrimet, befasitë dhe enigmat iu nënshtruan rrjedhës së ngjarjeve.

Për shumë njerëz është e vështirë që në buzëmbremjen e jetës të kujtosh dhe të kuptosh mëngjesin

e saj, sidomos në një paanësi të plotë, i pa trullësuar nga ajo që ka shkuar, nga mëria apo dashuria për ngjarje e njerëz të veçantë, i pa zhgënjyer nga pabesitë dhe trullësjet, i lirë nga gjykimi dhe rëndesa e kujtesës. Në kalimin e viteve ka ndryshuar perceptimi – ndaj ngjarja e disa dekadave më parë mund të shihet në një dritë tjetër; ajo që të ka pëlqyer dikur – tani është venitur dhe nuk të josh më; një ndodhi që dikur të ka lënë indiferent – tani zgjon kureshtjen tënde; njerëz tek të cilët ke besuar – tashmë të kanë zhgënjyer; diçka që nuk e ke përfillur dikur – tani të duket ndjellëse.

Zoti Bardha ishte njëri ndër liderët politikë dhe shoqërorë të diasporës shqiptare, me njohje të gjëra në botën e politikës amerikane, ndoshta në të vetmit që gjatë karrierës së tij ka takuar shtatë presidentë amerikanë, ka pasur korrespondencë me to; është, ndër të tjera, shqiptari i parë që ka folur para Kongresit Amerikan, një ëndërr e vjetër e shqiptarëve në Amerikë; ka gjetur

mirëkuptim, por edhe është përplasur me funksionarë të lartë që kishin në qendër të punës së tyre Shqipërinë, sidomos Kosovën, dhe që, kurdoherë ka gjetur busullën e drejtë dhe pikën më të duhur të aktivitetit të tij.

E kam shkruar diku një thënie të shkrimtarit të shquar francez, Stendal, se meriton të hidhet në letër vetëm ajo që mbetet interesante edhe pasi historia e ka dhënë fjalën e saj.

Ky është mendimi i parë kur merr në duar një libër me kujtime të zotit Ekrem Bardha, “E vërteta: Pavarësia e Kosovës, Amerika dhe Diaspora”.

Pra, a është një histori që ia vlejtur të hidhet në letër, diçka interesante, apo autori është zënë në “lakun” e jetës së tij dhe ka përcjellë atë që mund të jetë thjeshtë e vetja, diçka brenda familjes së tij, apo, si ndodh jo shpesh, ka sjellë hapësira të tjera, qoftë edhe përmes vetjakes; ka ndërthurë mallin me brengën, pa e sunduar asnjëra tjetrën dhe pa rënë viktimitë e mallit të prangosur



dhe brengës përmblytëse?

Për të deshifruar enigmën e një libri, apo edhe më tej, për të hapur enigmën e një libri, sepse çdo libër përmban një enigmë, njerëzit, e mes tyre edhe unë, kalojnë ose përmes njohjes me autorin, pra një njohje e hershme, dhe për hir të saj lexojnë librin, ose, pasi kanë lexuar librin duan të njohin edhe autorin.

Me mua ka ndodhur ndryshe. E kam njohur autorin nga larg prej shumë viteve. Nuk e dija nga ishte, se cili kishte qenë viti i tij i lindjes, njerëzit që kishte në shtëpi, rrugën që kishte bërë, çfarë bënte në jetën e tij vetjake, bile, duke mos qenë në Shqipëri, nuk e dija aq mirë as se cilat ishin lidhjet e tij.

E njihja atë përmes Kosovës. Ishte si të thuash një njohje nga larg për dy njerëz të ndryshëm dhe, kur them të ndryshëm, nuk e kam mendimin, të kundërt.

Ai ishte i arratisur nga Shqipëria, jo se nuk e kishte dashur vendin e tij, por shtigjet ishin të mbyllura befasisht dhe egërsisht dhe kishte gjetur një rrugë tjetër; ai i takonte së djathtës shqiptare, ndoshta kishte qenë edhe ekstremist, për deri sa kishte shkruar se “Nëse dikur ekstremizmin e çmoja duke e quajtur vendosmëri, më vonë fillova ta shoh si të dëmshëm”.

Unë kisha prirjet e mija drejt një të majte të moderuar; familja e tij, megjithëse pa armë, kishte qenë e lidhur me Ballin Kombëtar, ndërsa familja ime kishte qenë me Nacional çlirimtarë; ai, si mësova ishte biznesmen, ndërsa unë një njeri i varfër i letrave. Kishim një të përbashkët, por këtë e mësova shumë më vonë. Vëllai i tij Samiu ishte pushkatuar nga regjimi në vitin 1953, tetë vite më vonë, im atë do të kishte të njëjtin fat tragjik.

Por ai ishte një mbështetës i jashtëzakonshëm, ndër më të jashtëzakonshmit, i pavarësisë së Kosovës. I kudondodhur dhe i gjithë gjindshëm – ai kishte me vete simbolikën e një njeriu që i ishte përkushtuar Kosovës dhe naiviteti im politik e ndoshta, edhe ajo që të mbetet në mendje nga e kaluara, më bënte që gjenezën e tij ta lidhje me një qytet a krahinë malore në veriun e Shqipërisë, ta zëmë me Kukësin. Mendoja i bindur se ai ishte verior, dhe, kur e mësova se ishte kolonjar, nuk e di pse, por u gëzova dy herë.

Nuk do të mund të bënte pa u takuar një ditë. Kosova bashkon shumë njerëz dhe është e natyrshe që udhët e tyre të kryqëzohen.

Kur Presidenti i Kosovës më ftoi për një vizitë të përbashkët në Shqipëri, ku, mes të tjerëve do të takohej edhe me shkrimtarin Dritëro Agolli, menduam që, në këtë rast të dekoronte edhe disa nga figurat e shquara të botës intelektuale, të cilët, në vitet më të vështira të Kosovës, por edhe të kombit, kishin qenë në vendin e duhur dhe që, si shkruan studiuesi Moikom Zeqo, kishin qenë pjesë në aksionin e jashtëzakonshëm

konceptual dhe real për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës.

Ky është një fakt i pamohueshëm dhe i rrallë që lidhet me luftën epokale të UÇK-së si dhe të forcave të NATO, në vitet 1998 – 1999, një ngjarje e pashembullt kjo, që ndodh një herë në dymijë vjet, që çoi në ekzistencën e dy shteteve shqiptare të njëjtit komb. Ky ndryshim epokal nuk mund të arrihej nëse qendra e vendosjes së botës, SHBA, nuk do të shihnte drejt Kosovës dhe luftës së saj, dhe, kjo e fundit, nuk do të mund të sillej drejt ëndrrës shqiptare, nëse nuk do të kishte idealistë dhe vizionarë, shqiptarë të Amerikës, të cilët do e merrnin përsipër një rol të jashtëzakonshëm, si përfaqësues politikë të Kosovës në Amerikë, të ishin zëri i tyre, mendimi i tyre, një urë për bashkimi mes institucioneve të skalitura të shtetit amerikan, demokracisë dhe mendimit politik të atjeshëm, me atë që synonin në Kosovë lëvizjet politike, sidomos Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Njëri prej tyre, në më të çmuarit, ishte pikërisht zoti Bardha dhe, megjithëse nuk e njihja, nuk e kisha takuar asnjëherë, unë i propozova Presidentit Thaçi që, njëri ndër të dekoruarit, duhej të ishte edhe ai, çka u mirëprit dhe u shoqërua edhe më pas me vlerësimin maksimal, dekorime të tjera, për atë dhe familjen e tij.

U takuam shumë muaj pas kësaj ngjarje. U takuam në shtëpinë e lindjes sime në Shkodër, që njihet si Shtëpia e Madhe e Gjylbegajve, e ngritur nga Muharrem beg Gjylbegu, që kishte qenë edhe kryetari i parë i Bashkisë së Shkodrës në shtetin shqiptar. Disa vite më parë, në Londër, në zyrën e ambasadorit të jashtëzakonshëm, Agim Fagu, në mendimin tim më i shkëlqyeri në mbështetjen e Luftës në Kosovë, zonja Bianka Jagger, e Departamentit Amerikan të Shtetit, një grua jashtëzakonisht e bukur, inteligjente dhe e pasionuar pas çështjes shqiptare, mes të tjerëve me përmendi edhe zotin Bardha: “Është njëra nga portat e sigurta, përmes së cilës mund të hyni në Departamentin e Shtetit, por edhe në Senatin e Kongresin Amerikan”.

Tani, kaq vite pas luftës së Kosovës, të ardhur të dy nga anët e largëta të botës, u takuam, për të folur për shumëçka, por mbi të gjitha për Kosovën. Ai ishte nisur drejt saj nga një mësim i Abaz Ermenjtit, që në librat e dikurshëm ishte kryeballist, unë nga një lëvizje e majtë, por me theks të fuqishme irredentist e nacionalist.

Kosova e kishte pasur këtë fuqi, bashkimin e njerëzve.

Tani do i vinte radha librave. Fillimisht kisha lexuar librin e tij të parë. “Larg dhe afër Shqipërisë”. Kisha lexuar kujtime gjithë mllef, ndoshta nga që vuajtja kishte qenë më e rëndë nga sa ishte përfytyruar; isha njohur me poezi dhe libra që ri sillnin një epokë nga një kah tjetër, megjithëse ishin të

paktë, tani kisha me vete një libër, i cili, në titull hidhte idenë e mos shikëputjes edhe kur je larg, por që ende nuk e dija se çfarë do të kishte në brendësinë e tij.

Tani ai sjell librin e tij të ri. Një libër i madh nga idetë që përmban, nga vërtetësia deri në detaje, nga ngjarjet që përbëjnë ndoshta disa dekada jetë të një njeriu, libër i madh nga volumi, idetë, por, edhe nga përfshirja në të shumë figurave që bartin disa herë boshtin e kombit në fundin e shekullit të shkruar.

Çfarë kanë bërë shqiptarët e Amerikës për Kosovën? Çfarë kanë bërë ata figura të shquara, shumë nga të cilët kishin ikur nga Shqipëria londineze, duke lënë të afërmit e tyre, të cilët kishin hequr një pjesë të jetës në kampet e internimit, në burgje apo ishin eliminuar? Kishin pasur ata zemërim, mllef, urrejtje, kishin thënë ata: në drejt të veje edhe Kosova, ne kemi hallin e Shqipërisë, si kishte ndodhur me mërgatën e arratisur në Evropën perëndimore?

Si kishte ndodhur që atje larg ata kishin krijuar lobin e tyre, ishin forcë, njerëz të respektuar, në të gjitha fushat, ndërsa ndryshe kishte ndodhur me të tjerët, që, pas pak viteve rezistencë, në shumë raste kishin humbur përmes halleve të jetës dhe urrejtja ishte bërë pjesë e jetës?

Shumë enigma mund të ketë secili prej nesh. Është e natyrshe. Ajo që fshihet në vitet e shkuara, edhe kur zbulohet, krijon enigmat e saj. Zoti Bardha, në këtë libër, shkruar me pasionin e njeriut që e di se kjo mund të jetë “kënga e fundit”, pa u ngutur, ka ngritur “perden” e asaj që ka ndodhur, duke krijuar tablonë e një jete në përpjekje, pa harruar kurrë se atdheu është kudo ku janë shqiptarët.

\*\*\*\*

Si kishte rrjedhur jeta e një njeriu nga dita e kalimit të kufirit, nëpër natë, e gjithë familje njëherësh, deri tek takimet me presidentë, kongresmenë dhe senatorë, të cilët ishin aty, në foto të përbashkëta? Cila është jeta e një njeriu që ka takuar tetë presidentë amerikanë, që nga Niksoni deri në Biden?

Çfarë aspiratash kishte pasur ky njeri që ishte mik njëherësh edhe me Dritëro Agollin, Ismail Kadarenë, por edhe me Ibrahim Rugovën, Fehmi Aganin, Sali Berishën, Gramoz Pashkon... që në një pritje të ambasadës amerikane, ndryshe nga të tjerët, i jepte dorën presidentit të kohës Ramiz Alia, që takohej me drejtuesit më të lartë ushtarakë të NATO-s, por edhe me figura të shquara të shqiptarëve të Amerikës, që në ardhjen e parë në Shqipëri, pas kaq shumë viteve, pasi i ishte sjellë asaj nga të gjitha anët, do të deklaronte njerëzisht se “unë i takoj së djathtës, por partia ime është Shqipëria”?

Si ishte lidhur ky njeri kaq fort me

Kosovën, në luftë dhe në pas luftë, sa që do të njihej si mik i afërt i ish presidentit të ndjerë Rugova, më tej, i luftëtarëve Thaçi, Haradinaj, si kishte ndodhur përplasja në Departamentin Amerikan të Shtetit, kur një funksionar i lartë i Departamentit të Shtetit, në takimin me një grup shqiptarësh të njohur kishte thënë fjalinë e parë se “UÇK-ja është terroriste” dhe përplasja me të, deri në të pamundurën?

Për gjithë secilin mbetet vetëm të hapë librin. Aty janë të gjitha.

Nuk është një libër që lexohet me një frymë. Ai duhet lexuar duke e sjellë nëpër mend një epokë dhe disa ngjarje, emra e kalime që në kohëra të ndryshme kanë pasur përfytyrime të ndryshme.

I shkruar thjeshtësisht, pa fjalë të mëdha dhe pohe marramendëse, lehtësisht i qartë dhe mjeshtërisht tërheqës, ai sjell një hapësirë të re; përfytyrimin për Shqipërinë e një njeriu që për 45 vite ishte armik dhe që më pas doli se kishte qenë „armiku i mirë“. Dhe çfarë kishte bërë ai, e shumë miq të tij, figura të njohura, për Kosovën. Pavarësinë e saj.

Cila ishte e vërteta? A kanë qenë gjërat aq të lehta dhe, nëse do të kishin munguar përvoja, lidhjet, përkushtimi i tyre, çfarë do të kishte ndodhur? Kjo e vërtetë, deri tani pak e njohur, nuk është blerë me para, as me përlulje, por është arritur me dinjitet të pa skaj, nga njerëz që kishin krijuar emrin e tyre si figura publike dhe politike, që kishin njohje dhe bënë një pjesë të asaj që duhet njohur si pjesa e diasporës shqiptare në SHBA.

Ndodh kjo? Është e mundur?

Në fakt, është e vështirë të perceptohet, por, maksima e njohur se “Më shumë vlen një dëshmitar okular, sesa dhjetë vetë që kanë dëgjuar diçka”, këtu është në vendin e saj.

Në leximin e memuarëve të pas komunizmit kam pasur shpesh herë zhgënjime, ashtu si dhe jam tronditur e shpesh herë kam menduar se, gjuha i është dhënë gjithkujt, por mençuria pakkujt.

Si do të ndodhte kësaj here. Nuk doja të zhgënjehesha nga leximi i librit të një njeriu që e kisha lidhur më shumë me Kosovën, se sa me Shqipërinë.

Si shkrova, nuk është një libër që lexohet me një frymë, jo se nuk ka dinamikë dhe nuk bart atë frutën e të së panjohurës që e bën një libër interesant, por se duhet menduar gjatë leximit.


*Ka disa veçori ky libër, të cilat do të mundohem t'i sjell ashtu si i përjetova:*

Libri është plot të papritura. Nganjëherë tronditëse. Plor ide, përshkruar nga i njëjti motiv: atdheu në të gjithë përmasat e tij. Nuk ndjehet mllefi, hakmarrja, mëria për atë që ka përjetuar. Një libër pa mllef, gjë e pazakontë, për ata që kanë pasur më shumë dhimbje! Me plot besim se e ardhmja e kombit fillimisht duhet të ketë lirinë e Kosovës. Pa këtë nuk mund të ketë Shqipëri etnike dhe as besim se një ditë do të ndodhë bashkimi i shqiptarëve.

Libri është shkruar gjakftohtësisht, sikur autori ka nisur të dëshmojë jetën e një njeriu tjetër, që është vetvetja, por që mund të jetë edhe dikush tjetër. Mllef i që dëmton një libër nuk është. Nuk e gjen dot. As në rastet më të hidhura, kur jeta është çështje ditësh, as kur tradhtia e mikut është kobzeze, as kur vendi yt nuk të lë t'i afroresh.

Ai, autori, mund ta ndjejë veten fitimtar, brenda vetes së tij, por ky triumf nuk është. Nuk çirret, nuk mallkon, por dëshmon dhe në këtë rast, pikërisht kjo, dëshmia, është më e besuar.

Ai e di fare mirë se hakmarrja vulgare është e çastshme, hakmarrja inteligjente është e



përrjetshme. Ai ndërmerr këtë të fundit. Nuk sjell mallkimin, sepse do të ishte një lëçitës i zakonshëm, por shembullin, dëshminë, si të thuash, tregon pasaportën e të Vërtetës, duke qenë pjesë e saj, por pa rritur rolin e tij dhe mohuar të tjerët. Thjeshtë dëshmuës. Do të thotë, i besueshëm.

Libri është shkruar me Vërtetësi absolute, pa zbuluar dhe pa u mbërthyer nga nostalgjia, e cila mund të ishte e zakonshme. Një libër që ngërthen të vërtetën është gjithnjë i dashur, por, në këtë rast, kjo e vërtetë është edhe për ne, të tjerët, që, ose kemi qenë larg dhe kjo periudhë na ka zënë diku tjetër, ndoshta përballë me jetën e autorit, ose për ata që asaj kohe ishin soditës, për të mos shkuar më tej, ishin tronditëse në një realitet që pak kush e mendonte se mund të ndryshonte.

Vërtetësia është e habitshme, ndoshta deri në skajin e saj të mundshëm.

Është një libër i shkruar me shumë Dhembshuri. Ndoshta malli për vendin e tij, i tej zgjatur në vite dhe i paarritur, njerëzit e lënë diku tjetër, vendlindja e munguar, enigma e jetës së vëllait të burgosur, pengu i asaj që është braktisur, pamundësia për të qenë aty, si pjesë normale, e kanë shtuar dhimbjen, duke e bërë njerëzore. Kjo dhimbje është për gjithçka që ka shkuar dhe kujtimet e tij, prej kësaj ndjenje, janë bërë më të afërta e më njerëzore.

Përmes narracionit konciz, janë hequr fjalët e tepërta, të gjithë mund të binden se kjo është një jetë e pa zbuluar dhe nga ana tjetër fillon e krijon bindjen se tek ata që u arratisën, atdheu jetonte, shumë prej tyre ishin njerëz të ndjeshëm, të qetë, të pajisur me një botë të pasur dhe jo kamikazë. Kjo dhembshuri që ndjehet në shumë faqe të librit ka bërë që edhe ndaj atyre që nuk do e kishin merituar të ishin në libër, duke i dëshmuar të keqen, mashtrimin, krimin, të mos e çojë më tej tek të tjerët, në brezat, të mos mallkojë dhe të lëshojë gjëmën.

Në fakt është një libër i shkruar me Pasion. I menduar gjatë. Një libër i tillë nuk mund të shkruhet ndryshe. Në të vërtetë, vetëm njerëzit pasionantë mund të bëhen dëshmuës të qetë të një jete, e cila nuk është vetëm e tyra, por, në një mënyrë ose në një tjetër, sintezë e shumë jetëve, që ndryshuan rrjedhën e tyre, jo nga mos dashuria, përkundrazi; jo nga tundimi për të qenë kundërshtarë të domosdoshëm, por nga që rruga e zgjedhur ishte e vetmja e kohës.

Pasioni nuk e ka zbehur saktësinë, por e ka pajisur atë me flakën e domosdoshme që ka qenë në kohën e ngjarjeve një domosdoshmëri absolute.

Libri është shkruar duke përdorur brumin e saktë të Mendimit. Ky mendim ka qenë i domosdoshëm, pasi vetë lëvizja politike jashtë shtetit shqiptar ka pasur edhe



korifenjtë e saj, ashtu si ka pasur edhe të çarturit e saj. Një lëvizje që, aq sa është irredentiste, aq është edhe nacionaliste, duke kaluar nëpër sprovë të vështira dhe duke pasur nëpër këmbë një histori që nuk ishte e shkëlqyer nga disa eksponentë të saj, duhej të kishte mendim.

Libri është shkruar me shumë, shumë, ama, shumë Dashuri, e jo vetëm për Shqipërinë, duke e cekur atë në të gjitha hapësirën e saj, por edhe për Kosovën, për shumë nga personazhet që janë pjesë në këtë libër, për ata që ende janë pjesë e historisë dhe të tjerë që kanë dalur jashtë saj, për prindërit e të afërmit, ku spikat figura mitike e Nënës, Bule, bashkëpunëtorët dhe miqtë e tij, deri tek selitë e larta të Kongresit dhe Senatit Amerikan.

Është një konfiguracion i gjerë njerëzor, i përmasave sa të afron një jetë e tërë, por edhe i shikimit tej ngastrës së një familje, në të cilën ai është i pranishëm, por që nuk është e mjaftueshme për synimet e tij.

Libri është mesazh Atdhedashurie. Kjo e vërtetë e përshkon gjithë librin. Kryefjala e librit është atdheu, shikimi ndaj tij është i vazhdueshëm, pritës, lakmitar dhe gjithë mall; ankthi i largimit nuk është asgjë para ankthit të braktisjes, qëndrimi ndaj vendlindjes është gur prove, koha e ribashkimit është e shumëpritur, dhe, vjen një çast, do të thosha determinues, kur "armiku" bën atë që nuk mund ta bënte diplomacia e shtetit shqiptar: takohet me presidentin Richard Nixon.

Shkaku është i pazakontë. Në shtetin grek qeverisin ushtarakët, të cilët, sapo kanë shfaqur pretendimet e tyre për aneksimin e jugut të shtetit shqiptar. Përmes miqve të përbashkët ai arrin të takohet dhe t'i kërkojë që shteti amerikan të mos lejojë që atdheu i tij të copëtohet edhe më tej.

E pabesueshme, por e vërtetë. Presidentit amerikan i bën përshtypje të thellë këmbëngulja e një të arratisuri nga shteti i tij dhe i premtos se nuk do të lejojë që Shqipëria të shkërmoqet nga qeveria e kolonelëve dhe, për më tepër, pa e hequr nga mendja, e fton në ceremoninë e betimit të tij si President. Për të vërtetuar fjalën

e tij, presidenti amerikan shkruan me dorën e tij, betimin që porsa ka bërë.

Së fundi, por jo më e parëndësishmja, libri është shkruar me Modesti. Është mbivlera e një libri të vyer dhe të vlefshëm. Është e vështirë të jesh modest pas triumfit. Diçka që ngjan e pamundur, sidomos në çastet e para.

Në fund të fundit ai ka pasur gjithnjë këtë synim të dyfishtë: kthimin e shtetit shqiptar në një shtet normal, demokratik dhe, më tej se kaq, lirinë e Kosovës. Ia ka arritur të dyjave, për më tepër, duke qenë pjesë dhe jo soditës. Duke u bërë zë i rëndësishëm dhe jo i humbur në hapësirën e pafund amerikane. Duke sakrifikuar nga vetja, por duke i dhënë të tjerëve. Duke hapur pritat për të gjithë shqiptarët, por duke pritur në shtëpi edhe presidentë amerikanë. Duke qenë mik me shqiptarët e zakonshëm, por edhe me figurat më të larta presidenciale.

### Njëri prej tyre, George W. Bush, në 15 janar 2001, do i shkruante:

I dashur Ekrem,  
*Dick Cheney dhe unë duam t'ju falënderojmë për gjithçka që ju keni bërë për ne. Udhëheqja juaj, energjia dhe koha, që ju na dedikuat bujarisht, ishin vendimtare për suksesin tonë.*

*Unë ju jam mirënjohës për punën tuaj këmbëngulëse dhe i nderuar që ju bënit pjesë në grupin tim.*

Në fund të fundit do të jetë shqiptari i parë që hap dyert e Senatit dhe të Kongresit Amerikan, gjë që e kishin pasur ëndërr figurat e mëdha të kombit.

Libri, në të vërtetë, është jeta e tij. Cila ishte ajo? Për shumë vite me radhë ishim mësuar se "ne", që jetonim në këtë vend, që nuk e kishim lënë atë, megjithëse të strukturuar si në palcën e vetëdijes sonë, ishim kombi, ishim atdheu, ishim identiteti, tek "ne" ishte gjithçka e mirë që mund të kishim bartur nga njëri brez në tjetrin.

"Të tjerët", të vetë larguarit, të mënjeluarit, humbësit ishin njerëz pa identitetin e tyre, ata identifikoheshin me atë që nuk duhej të ndodhte, ishin të pandryshueshëm në urrejtjen e



tyre. Ata, ndryshe nga "ne", domosdo do të ishin antikombëtarë, përhapës të së keqes, tempulli i të cilëve ishte mëkati ndaj vendit ku kishin lindur.

Dyshimi i parë kishte lindur së bashku me përhapjen e lirisë së fjalës. Nuk kishin qenë të gjithë djaj, ashtu si nuk kishin qenë të gjithë engjëjllorë.

Hapja ishte mundësia e vetme e njohjes dhe vetë njohja kishte sjellë mundësinë e mendimit ndryshe. Nuk kishte qenë e thënë që për të vetë larguarit, të arratisurit të mishërohej ajo që ishte thënë në njërën nga librat e shenjtë, Biblën, se "Dhe ti do të jesh një endacak dhe ikanak mbi tokë" (Zanafilla 4-12).

Ata, që ishin menduar se nuk do e kishin kurrë shtetin e tyre, nuk do të kishin as arkivat dhe kujtesën e tyre, në fakt e kishin bartur kombin, vendin, ashtu si edhe fatin e tyre. Kur do të vinte koha e duhur ata do e shpallnin të vërtetën që fillimisht do e kishim vështirë ta njihnim se, edhe këmbë përgjakur, nga një dënim i rëndë dhe i pashpjegueshëm, nuk kishim humbur atë që do të ishte primare dhe e domosdoshme, identitetin.

Njëri prej tyre, ndoshta më domethënësi, kryelartë dhe i përkulur njëkohësisht, do të ishte Ekrem Bardha, tek i cili shpirti i njeriut kishte qenë më shumë se gjithçka dhe se braktisja e atdheut nuk kishte qenë asgjë tjetër veçse afrim drejt tij.

Ekrem Bardha është njëri ndër simbolet e shkrirjes së jetës për një pjesë Shqipërie, të cilën, sa ishte në vendlindje, nuk e kishte njohur, kishte ditur shumë pak për të, krejt pak, vetëm atë që mund të ishte thënë në fisin e tij, por që si një normalitet njerëzor do të bëhej një gjymëtarë e tij, një vazhdim i jetës së natyrshme dhe si një domosdoshmëri e përcaktuar. Kosova do të jetë malli, megjithëse nuk e kishte parë; do të ishte përkushtimi, në vorbullën e jetës do të kishte dallgëzuar më shumë se sa kaq; do të ishte qëllimi dhe kësaj ia arriti.

*Kallëzomë udhënë e dërritë, pash bukënë* – do të shkruante Frang Bardhi në vitin e largët 1636.

Cila do të ishte udha e drejtë e

Ekrem Bardhës? Do e kishte menduar gjatë asaj nate, kur ende 20 vjeçar, do të arratisë nga Shqipëria. Shteti i parë i huaj ku do të vinte këmbën ishte Greqia. Një familje e tërë, që kishte lënë pas një varr vëllai, do e kishte stacionin e parë dhe më të vështirin. Viti 1953 ishte i skajshëm mes dy shteteve. Nëse nuk do të mund t'ia prisnin kokën njëri tjetrit, do ia nxirrnin sytë me shumë dëshirë.

Në Greqi do të jetë ndaj një udhëkryqi të parë, që kurrë nuk u bë pikëpyetje: shteti grek, shërbimi i tij, i kërkon të bëhet bashkëpunëtor i tij. Nuk ka asnjë lëkundje se kjo nuk është udha e drejtë, por, edhe nëse do të kishte një fillësë luhatje, atë ia shuan menjëherë nëna e tij, nëna Bule: Ikëm për t'i shërbyer vendit tonë, për njerëzit tanë e jo për të huajt që vranë na kanë dhe shuar kanë dashur të na kenë. Pastaj do i thotë vetes së vëllai i tij i madh, Sami Bardha, i ekzekutuar në burgjet e pas luftës, nuk kishte qenë për një shtet të copëtuar, barbarisht të ndarë, ai nuk e kishte dashur komunizmin, por Shqipërinë e kishte dashur.

Rrugëtimi do të jetë i gjatë, por udhën e drejtë e kishin gjetur. "Regjimi është diçka tjetër, atdheu është tjetër. Regjimi edhe ndryshon, atdheu mbetet i njëjtë".

\*\*\*\*

E ka menduar gjithnjë Ekrem Bardhën si një banor i veriut të Shqipërisë, diku në zonat kufitare, kur ende nuk dija rrugëtimin e tij të gjatë, gati pesë dekadash drejt Kosovës. Vonë, shumë vonë, kam mësuar se ishte kolonjar. Kishte thyer një tabu të pavendosur, por të menduar. Kishte sjellë pranë vetes vise e troje të panjohura, për t'i njësuar me ato të vendlindjes së tij. Ishte një fillësë e pazakontë, në dukje e papërbalueshme, tepër e rëndë për t'u bartur nga njerëz që ishin kaq larg vendit të tyre, ku edhe e kishin të ndaluar të hynin, por që kishte nisur bulimin në një kohë kur pak vetë, vetëm një grusht idealistësh e mendonin këtë. Vizioni është më i fuqishmi ndër të gjithë mendimet njerëzore. Drejt vizionit do e shpinte një njeri i njohur; më shumë mendimtar se sa luftëtar; ballist dhe me njërin



Ekrem Bardha, Bill Clinton dhe kongresmenët Gephard, kryetar i Grupit Parlamentar Demokrat në Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan, dhe David Bonior, nënkryetar i Grupit Parlamentar Demokrat në Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan, Michigan, 16 prill 1999.

këmbë në idetë sociale, sa që shërbimi i fshehtë amerikan do e klasifikonte si përfaqësues i krahut ballist socialist, Abaz Ermenji.

Këto dy njerëz do të takoheshin një ditë. Edhe nëse nuk do të kishin qenë pjesë të Ballit, do të takoheshin.

Ekrem Bardha i tregon se si e kanë lënë vendin e tyre, atë jetë të braktisur dhe është i gatshëm të marrë përsipër shumë më tepër se sa mund të pritej. Ermenji i tregon një rrugë tjetër, po ashtu të drejtë. I thotë se Shqipëria, në mos sot, një ditë tjetër, do të ndryshojë. Ajo nuk do të zhduket, nuk do të shpërbëhet. Do të vuajë, por do të mbijetojë. Kosova, pjesa tjetër e atdheut, është në fillin e perit.

Nëse ky fill këputet, atëherë nuk do të ketë më Kosovë. Do të jetë një pjesë e harruar, ashtu si viset e tjera shqiptare. Komunizmi është armiku ynë, do i thotë Ermenji, por Serbia është dy herë e armiqësuar me shqiptarët. Nëse nuk do të ketë Kosovë, atëherë nuk do të ketë as Shqipëri.

Është një bisedë që do i mbijetojë viteve, sepse bëhet ide, qëllim, vizion, përkushtim, mendim i përditshëm dhe lëvizje.

Fjalët e Ermenjit janë testamentale. Tregomë, zot, rrugën e drejtë! Në Amerikë Zoti ka dërguar apostujt e shqiptarisë. Njëri prej tyre ka lënë pas veprën e shkruar dhe erudicionin e lakmueshëm, si shqiptari më i ditur dhe më famë madh në atë shtet të largët; tjetri jeton ende dhe është simboli i një shqiptarie të habitshme.

I pari, Konica, është njeriu që ka zbuluar dhe bërë publik flamurin e Skënderbeut. E ka gjetur i vetëm, duke gërmuar në arkivat e gjithë botës. Tjetri, Noli, krejt i vetëm, ka bërë po ashtu një akt të

pashembullt: ka krijuar Kishin Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Një vepër titani, frut i vullnetit të fortë dhe i mendjes së zgjuar.

Konicën ai, Ekrem Bardha, e ka njohur përmes librave dhe kujtimeve, me Nolin lidh miqësinë që do të vazhdojë deri në aktin e fundit. Noli, i cilësuar si i majtë dhe, Bardha, i trajtuar si i djathtë, kanë mes tyre një urë lidhëse: të drejtën sociale në perceptimin e së përditshmes dhe nacionalen në kujtesën e vazhdueshme.

Për të ngritur rrugën e Kosovës do të kishite vetëm një rrugë: Shtëpia e Bardhë, senati dhe Kongresi. Është e pamundur të perceptohet një rrugë tjetër. Ndoshta, pa e ditur atë thënien e vjetër dukagjinase se, "kur ke zotin dajë, nuk ke nevojë për engjëjt", ai i drejtohet pikërisht atyre.

Tanimë nuk është i panjohur. Është një njeri i pasur, i virtytshëm, idealist; çdo gjë e ka ndërtuar me mendjen e guximin e tij, edhe në ato fusha ku të tjerët nuk guxonin dhe që i quanin të papërshtatshme për shqiptarët: sallonet e modës dhe gastronominë.

Duhen njohur dhe afruar kongresmenë, senatorë, ligjberës, figura të shquara të mendimit politik amerikan. Përmes tyre mund të ketë një mendim për Kosovën dhe në këtë rrugëtim ka fatin të mos jetë i vetëm. Një pjesë e emigracionit shqiptar në Amerikë, ku bën pjesë edhe Ekrem Bardha, e kuptojnë fare mirë se mllëfi ndaj komunizmit nuk duhet të errësojë kombin.

Është një lobim i vështirë. Ndoshta më i vështiri që ka pasur në fillimet e tij hezitime të shumta, pengesa, moskuptime dhe , ndoshta, pengje të harresës.

Përmenda "harresën" se ishte një

rrugë që zgjati 40 vite, gjatë të cilëve, zyra e një njeriu të zakonshëm, arratisur një mbrëmje qershori të vitit 1953 nga vendi i tij, bëhet institucioni i vetëm shqiptar, ku janë bërë takime të nivelit të lartë me figura të shquara të politikës amerikane, shkëmbehen korrespondenca, projektohen lëvizje të reja, mendohet për krijimin e një lobi amerikan pro çështjes shqiptare; afrimet bëhet ngadalë, fillimisht është mosbesimi ndaj çështjes që zbehet gradualisht me besimin ndaj njeriut që e përcjell këtë mesazh; kur zyra e tij nuk është e mjaftueshme, e gjithë shtëpia e tij kthehet në një qendër bashkëbisedimesh; kur personeli është larguar, atëherë përveshin mëngët pjesëtarët e tjerë të familjes; dyshimet e moskuptimeve të para fillojnë dhe i lënë vendin shpresës, nis e zgjohet besimi se rruga është e drejtë dhe se mundësitë po hapen. Takimet e para janë të mbushura me heshtje dhe një ndjenjë pritje, pasi gjithçka zhvillohet larg shtetit të madh amerikan, ku e dhëna e rreme ka zënë vend për fatin e Kosovës dhe kjo duhet shkundur. Shumë kush do të ishte tërhequr, do kishte heshtur. Nganjëherë lodhja do të jetë aq e madhe, sa që do të mendohej se, edhe kaq, sa është bërë, është e mjaftueshme për të mbushur një jetë njeriu. Por tanimë, ai ka marrë përsipër jo vetëm rolin e tij, por edhe të tjerët; gjithçka është shtrirë në sinorë të tjerë dhe Kosova fillon e bëhet një emër i dëgjuar në hallet e administratës së lartë të Amerikës.

### Presidentët Amerikanë

Në rrugën e drejtë që zgjodhi Ekrem Bardha do të takohej me

shtatë presidentë të Shteteve të Bashkuara. Me gjashtë prej tyre do të bisedojë vetëm për Kosovën; në njërin takim, në takimin e parë me një president të shquar, Riçard Nikson, do të bisedojë për Shqipërinë.

Zbuluesi shqiptar Hasan Luçi do të jetë i pari që do të informojë për këtë takim shërbimin e tij të zbulimit të jashtëm. Ai do i shkruajë shefave në Tiranë se, "Ekrem Bardha, shqiptar i njohur, është takuar me presidentin Nikson. Tema e takimit të tyre nuk dihet, por, nga informacionet e ardhura, ka të dhëna se Ekrem Bardha i ka kërkuar Presidentit amerikan mbrojtjen e territorit shqiptar nga një agresion i mundshëm i Greqisë".

Në Greqi është në fuqi junta ushtarake. Ajo sapo ka bërë një deklaratë për luftë ndaj shtetit shqiptar. Është një gjendje që trazon shqiptarët që e kishin dashur vendin e tyre, jo si sundues, por si shërbëtorë të tij. Është viri 1968. Ai e informon presidentin Nikson se junta e kolonelëve grekë kanë shfaqur haptas pretendimet e saj për aneksimin e jugut të Sqipërisë.

Një shqiptar i larguar nga vendi i tij futet në Shtëpinë e Bardhë për të mbrojtur vendin që e ka braktisur. Presidenti amerikan në praninë e kongresmenit William Broomfeld, i thotë se kjo gjë nuk do të ndodhë kurrë. Më pas, duke i dërguar një letër personale, i premton se, "unë nuk do të lejoj që pretendimet greke për territore shqiptare të realizohen".


*Udhënë e dërejtë* Bardha e vazhdon më tej. Nëse e kishte filluar me besimin se do të bëhej një ditë një ëndërr e tashme, duhej vazhduar. Shumë gjëra do i mësonin më vonë. Koha e harresës

do të grisej një ditë dhe habitshëm do të mësohej se çështja e Kosovës do të shtrohej para kongresmenëve amerikanë që me 20 maj 1975, se me 23 maj 1980 do i dërgohej një informacion i detajuar Departamentit të Shtetit për gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi, se gjërat pastaj do të lëviznin më shpejt dhe pak ditë më vonë, me 28 maj 1980 Ekrem Bardha, i sugjeruar nga Departamenti i Shtetit, ftohet në Konferencën e Madridit për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, për të diskutuar mbi të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi.

Kornizat e vjetra bien, traseja e re fillon e shtrohet. Ende pak vetë e besojnë se mund të ketë ndonjë dobi nga gjithë kjo lëvizje e një lobi shqiptar, të cilët, për më tepër, megjithëse të pasuruar me punë të ndershme, nuk ngurrojnë të shpenzojnë pasurinë e tyre.

Ngjarjet historike të sjellë në libër përmes dokumenteve autentike, kujtimeve, letër këmbimeve, letrave të figurave të shquara , takimet në institucionet më të rëndësishme, përplasjet, të gjitha këto përbëjnë korpusin e madh të librit. Rrezatimi i punës së tij përhapet në të gjithë familjen. Në kohën e luftës së Kosovës janë përfshirë të gjithë, që nga momentet madhore, takimet me presidentin Klinton, deri në kampet e ngritura për të dëbuarit shqiptarë nga dhuna serbe. Një letër e Donika Bardhës bëhet shkak madhor për reagimin e presidentit Klinton dhe nis një rrugë e re, përmes një betimi që i bën presidenti i luftës: Serbët do e paguajnë këtë që po bëjnë në Kosovë.

Është një libër i veçantë. Ndoshta më i veçanti që ka sjellë kujtesa e diasporës. Më domethënësi.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Ballkani mposhti Dritën, lufta për titull bëhet dramatike

### “Epoka e re”

**GJILAN, 7 MAJ** - Kampioni në fuqi, Ballkani ka shënuar fitore tejet të rëndësishme si mysafir në Gjilan ndaj Dritës, në kuadër të javës së 33-të në Albi Mall Superligë, duke e bërë garën për titull shumë interesante. “Portokallezintë” e Suharekës fituan me rezultat 2:1, duke e barazuar kuotën e pikëve me Dritën (66) në krye të renditjes. Ballkani kaloi në epërsi me një gol të Meriton Korenicës, në minutën e 11-të, ndërsa Muharrem Jashari barazoi shifrat në minutën e 43-të. Ndonëse në pjesën e dytë më shumë nga loja pati skuadra vendase, ishte Lumbardh Dellova, i cili në minutën e 85-të ia solli fitoren Ballkanit, me golin e shënuar me gjuajtje me kokë, pas një harkimi nga këndorja. Edhe pas kësaj humbjeje, Drita mbetet lidere dhe fatin e titullit e ka në duart e veta, ngase nëse i fiton tri

ndeshjet e mbetura atëherë do t’i gëzohet trofeut. Dy ndeshjet e tjera të ditës së sotme u mbyllën pa fitues dhe pa gola. Ferizajt shkëputi një pikë të rëndësishme në stadiumin “Zahir Pajaziti” në Podujevë në përballje me Llapi, duke arritur në kuotën e 35 pikëve, edhe pse ende mbeten në pozitën e parafundit. Ndërkaq, Gjilani shkëputi një pikë si mysafir në stadiumin “Fadil Vokrri” në duel me Prishtinën, duke e mbajtur këtë të fundit në distancë prej 7 pikësh. Gjilani luajti me një futbollist më pak në fushë nga minuta e 78-të, pasi Arbnor Ramadani u ndëshkua me kartonin e dytë të verdhë. Drenica është skuadra e parë e Albi Mall Superligës së Kosovës që nga edicioni tjetër do të bëjë gara në një rang më të ulët të garave. Kuqezinjët kanë humbur gjasat për të dalë nga zonat e rrezikshme pas humbjes së pësuar të shtunën kundër Trepçës '89, me rezultat 3:1, në kuadër të xhiros së 33-të.



Kur kanë mbetur edhe tri xhiro deri në fund të kampionatit, Drenica ndodhet në pozitën e fundit në tabelë, me 23 pikë dhe tani më e ka të pamundur ta ngjitet në pozitën e tetë, e cila siguron ndeshjen e barazhit. Kjo do të jetë hera e parë që Drenica do të përshëndetet nga elita e futbollit kosovar. Golat e fitores për Trepçën '89 i shënuan Egzon Fazliu (3'), Madi Karamo Fatty (40') dhe Rilind Nimani (46'), derisa

golin e vetëm për kuqezinjët e Skenderajt e shënoi Osman Mëziu. Ndërkohë, në ndeshjen tjetër Dukagjini fitoi me rezultat 1:0 kundër Malishevës në stadiumin “18 Qershori” në Klinë, duke i mbajtur gjallë shpresat për pozitën e tretë, e cila siguron daljen në Evropë. Golin e fitores për skuadrën e Armend Dallkut e shënoi nigeriani Otto John, në minutën e 86-të. Pas kësaj fitoreje, Dukagjini aktualisht

### SUPERLIGA

Drita - Ballkani	1-2
Prishtina - Gjilani	0-0
Llapi - Ferizaj	0-0
Dukagjini - Malisheva	1-0
Trepça '89 - Drenica	3-1

### Tabela

1. Drita	66 pikë
2. Ballkani	66
3. Gjilani	51
4. Prishtina	44
5. Dukagjini	44
6. Llapi	42
7. Malisheva	39
8. Trepça '89	37
9. Ferizaj	35
10. Drenica	23

ndodhet në pozitën e katërt, me 44 pikë, 6 më pak se Gjilani i pozitës së tretë. Në anën tjetër, Malisheva pas kësaj humbje mbetet në pozitën e shtatë, me 39 pikë. Në xhiron e ardhshme, Dukagjini do të luajë kundër Drenicës, ndërsa Malisheva do të presë Prishtinën në stadiumin “Liman Gegaj”.

## Istogu fiton Kupën e Kosovës për herë të pestë

**PRISHTINË, 7 MAJ** - Istogu ka dominuar në finale për ta fituar Kupën e Kosovës për herë të pestë. Madje gjithë trofetë i ka fituar në gjashtë vjetët e fundit. Të dielën në Prishtinë, Istogu në finale e mposhti Vushtrrinë me rezultat bindës, 32:21. Istogu ishte bindës edhe në gjysmëfinale ndaj Ferizajt dhe kështu llogaritet favorit edhe për titull të kampionit. Në finalen ndaj Vushtrrisë, lojtaret istogase nisën herët shkëputjen në rezultat. Në minutën e nëntë rezultati ishte 5:1. Më pas epërsia ka shkuar duke u rritur dhe fitorja e Istogut nuk është rrezikuar asnjëherë. Albina Rugova ishte më efikasja tek Istogu me



shtatë gola. Nga katër i shënuan Dajana Milaniq, Pranvera Ferataj e Dayane Da Rocha. Tri gola i kishte Tainara Luna Goncalves, që u shpall MVP i turneut final të Kupës. Te Vushtrria, Burneta Rama i

shënoi gjashtë gola, ndërsa nga pesë i kishte Kosovare Avdiu. Kupën, kapitenes së Istogut, Albina Rugova, ia dorëzoi presidenti i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini.

## Peja shkatërron Trepçën në finalen e dytë

**PEJË, 7 MAJ** - Peja është treguar skuadër shumë e fortë në ndeshjen e dytë finale ndaj Trepçës, në ballafaqimin e zhvilluar në palestrën “Karagaç”, në Pejë. Që nga minuta e parë e deri tek ajo e fundit, verdhë e zinjët u treguan superior ndaj mysafirëve duke udhëhequr gjithmonë me më shumë se 15 pikë epërsi dhe që në fund fituan me rezultat të thellë 107-79. Kështu pas kësaj ndeshje është barazuar seria e fitoreve në 1-1, gjë që garanton spektakël në ndeshjen e tretë që do të zhvillohet në Mitrovicë të enjten. Kujtojmë se ndeshjen e parë e fitoi Trepça të mërkurën e kaluar në palestrën “Minatori” në Mitrovicë.



Skuadra që arrin tre fitore në këtë seri do të shpallet kampione e Kosovës në basketboll.

## Arsenali mposhti Newcastelin dhe vazhdon garën për titull

**LONDËR, 7 MAJ** - Arsenali nuk ka ndërmend të dorëzohet për titullin kampion. Skuadra e Artetës mori një fitore spektakolare 2-0 në transfertën ndaj Newcastle. Martin Odegaard zhbllkoi ndeshjen me një goditje

spektakolare nga distanca. Newcastle ndërkohë kishte pafund raste shënimi, por portieri Ramsdale e ndali për mrekulli. Nga ana tjetër Pope u detyrua të bënte heroin në të paktën tri raste, duke mohuar gola të sigurt. Kur pritej goli i

vendasve, Arsenali do të gjente dhe golin e dytë falë një autogoli të Fabian Schar, i cili e dërgo topin në rrjetën e portës së tij. Arsenali ngjitet në kuotën e 81 pikëve, vetëm 1 më pak se City, ndërkohë që Newcastle mbetet e treta me 65 pikë.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

